

Manual i Organizimit te Klubeve Studentore

2011-2012

Hyrje

Informacion mbi Regjistrimin

Udhëzimet

Planifikimit i Projekteve për financim dhe Forma

Vlerësimi i aktiviteteve

Listë e plotë e planit të eventeve

Publiciteti dhe publikimi online

Informacion rreth kontakteve të aktiviteteve

Memo

Lista e Aktiviteteve Studentore

Programi i Klubeve

Bashkëpunimet

Të drejtat dhe detyrat e Zyrës së Klubeve Studentore.

Hyrje

Të dashur Studentë të Klubeve

Urime për pozicionet tuaja udhëheqëse dhe dëshirën për të marrë pjesë në Komunitetin e Klubeve të Universitetit “Marin Barleti”. Organizimet e studentëve janë një element kyç për krijimin e bashkëveprimit pozitiv në kampus, me qëllimet për të ndihmuar organizatën dhe mundësuar që rrjeti të vazhdojë si një tipar qendror në jetën studentore. Ne kemi krijuar këtë manual të informatave thelbësore për referencë dhe shpresojmë se ky manual do të ndihmojë për të sqaruar pyetje që lindin, çdo paqartësi dhe informace për të cilat, ju, mund të jeni në dijeni. Studentët e Marin Barletit dhe studentët aktivë në klube kanë ngritur dy shtylla të mëdha mbështetur në inkurajim, stërvitje dhe informacion të gjerë. KS sigurojnë fonde për të zhvilluar aktivitete studentore universitare, përveç në fonde të veçanta sipas kërkesës, gjithashtu mbajnë mbledhje javore për të diskutuar çështje të ndryshme të kampusit dhe këto takime janë zakonisht të hapura për të gjithë studentet. Në Zyrën e Klubeve Studentore veprimtaria e studenteve është vendosur në plane qendrore, kjo zyrë lehtëson orientimin e studentëve të rinj, i këshillon ata dhe ndihmon drejtuesit e studentëve për nevojat e tyre. Mos harroni se KS dhe Student Aktiv janë një burim për organizatën tuaj dhe janë të përgatitur për të ju ndihmuar në arritjen e qëllimeve që keni, për informacion kontaktoni anëtarët e stafit të KS dhe Student Aktiv.

Organizatat e studentëve janë një mjet i shkëlqyer për shprehjen e interesave të përbashkëta dhe ne mendojmë se UMB është me fat që ka disa organizata, për një gamë të gjerë të interesave të studentëve. Çdo klub është një pjesë e vlefshme e këtij komunitetit dhe ne jemi krenarë që udhëheqim me profesionalizëm pjesëmarrjen e secilit prej tyre. Ne do të donim që ju, të njiheni me të gjithë punën e bërë nga stafi profesional, për aktivitetet studentore në hartimin e këtij manuali. Mbështetja juaj ka rëndësi të madhe.

Ju falënderoj për angazhim tuaj si pjesë aktive e Komunitetit. Në qoftë se keni ndonjë pyetje, ju lutem mos ngurroni të email koord.klubstud@umb.edu.al

Sinqerisht,
Anisa Brano, Zyra e Klubeve Studentore, Koordinatorë.

REGJIST

RIMI

Regjistrimet dhe Informacioni

Klubet Studentore, në mënyrë që të marrin fonde nga organizatat të ndryshme, duhet të plotësojnë dhe të lexojnë këtë dokument në tërësinë e tij dhe të përmbushin këto kërkesat. Në qoftë se një klub nuk është në përputhje me këto rregulla, mundësia e financimit të tyre mund të reduktohet.

- ✚ Të kenë një rregullore aktuale dhe dosjen e cdo klubi studentor
- ✚ Të zgjedhin një minimum prej pese anetaresh : Keshilltari i Klubit, Perfaqesuesi dhe Anetaret mbeshtetes.
- ✚ Keshilltari duhet të marrë pjesë në takime të cila ndërmeren nga Zyra e Prorektorit dhe Dekanit te veprimtarive të studenteve.
- ✚ Të paktën dy përfaqësues duhet të kenë të drejtën për udhëheqje të klubeve duke zëvendësuar njëri-tjetrin.
- ✚ Anëtarët e tjerë duhet të ndjekin të gjitha mbledhjet e klubit dhe të ndjekin të gjitha udhëzimet për të marrë fonde për projektet e tyre.
- ✚ Duhet të plotësohet formulari i regjistrimit një herë në vitë duke e dërguar atë, në zyrën e koordinatorit të klubeve. Regjistrimet janë të hapura për gjatë gjithë vitit akademik 2011-2012.
- ✚ Informacionet e abdetuar do të meren nga zyra e Koordinatorit ose Këshilltarit të klubit, me ndryshimet e aktiviteteve studentore më të fundit.
- ✚ Mbajtja ne arkive e kontakteve dhe të dhënave personale të antaresuarve në klubet studentore.

Suksesi i organizatës së klubeve studentore nuk varet vetëm nga udhëheqësit e grupit, por nga anëtarësimet e tyre, perfshirjane tyre efektiv si emocionuese apo zhgënjyese, ku në fund të fundit do të siguroje suksesin e klubit. Përfshirja e anëtarëve të rinj jo vetëm që ndihmon grupin, por mund të përcaktojë përfundimisht jetëgjatësinë e këtij klubi. Këta studentë mund të sjellin ndryshime tek lidhjet shoqërore në kampus me përdorimin e aftësive dhe përvojave të tyre. Ata mund të ndjehen të nevojshëm, të rëndësishëm , u jepet mundësia që të jetë krijues, të fortësojnë njohjet, kontaktet sociale, idet e reja, të marrin përsipër të realizojnë sfida etj.

Udhëzimet

UDHËZIMET PËR NJË KLUB TË RI.

HAPAT për krijimin një klub të ri

A nuk e shikoni si një organizatë që ju intereson? Filloni tuajën. Çdo student mund të fillojë organizimin e tij, në përshtatje me interesat e tyre, për sa kohë nuk është një organizatë e ngjashme në vend. Niseni këtu për të filluar rrugën tuaj të udhëheqjes.

Qëllimi për të formuar një Klub

Qëllimit për të formuar klubin është hapi i parë që klubi ndërrmer, pasi forma dhe përmbajtja është plotësuar dhe dorëzuar, atëherë organizata marr përsipër detyra të caktuara. Cdo anëtar i ri duhet të di se:

Si do ta përcaktojë Klubin?

Cilat janë qëllimet e propozuara?

Çfarë shpresojm të kryejm?

Si do të përshtatet kampusi me ne?

Çfarë roli nuk duhet të luaj?

Kush do të funksionojë si këshilltar?

A ka një zyrë ku ose do të jetë e lidhur me

Anëtarësia

A ka studentë të tjerë që ju tashmë i dini që do të duan të bashkohen me klubin?

Si do te identifikoheni nga të tjerët?

Si do ti bindësh ata për t'u bashkuar me klubin?

Çfarë lloje angazhimesh do te ndermarin klubet?

Çfarë e bën këtë klub unik?

Struktura

Do të jetë kjo në një formë zyrtare apo një llojë formimi i të punuarit për një çështje apo veprimtari të veçantë?

A do të ketë një zyrë?

A keni një strategji?

Sa të shpeshta do të jenë takimet e organizatave? Kur dhe ku?

Shënim i rëndësishëm: Klubet e reja duhet të ndjekin proceset e përshkruara më poshtë, në mënyrë që të njihet si një klube zyrtare.

1 – Plotësimi i formularit. Ku jepen disa informacione bazë dhe tregohen qartë qëllimet dhe misionet e klubeve. Duhet plotësuar një draft përshkruar në lidhje me Klubet, duke përfshirë të gjitha nënshkrimet e nevojshme, rreth aktivitetit të Klubit. Ky material duhet dorëzuar tek Dekani i studenteve duke marre miratimin e tij dhe me pas do të dorëzohet tek Koordinatori i klubeve për regjistrim dhe shpërndarje të mëtejshme tek anëtarët e klubeve.

2-Të mblidhen së paku 5 anëtarë (studentë) të gatshëm që të marrin pjesë në aktivitetet e klubit. Anëtarët duhet të ketë një kartë identiteti ose studenti të vlefshme.

3 - Të bëhen zgjedhje të përfaqesuesit dhe këshilltarit.

a. Përfaqësuesit duhet të jenë punonjës në Universitetin “Marin Barleti” dhe duhet të konsolidohen me aktivitetet e klubeve, duke marr pjesë në takimet zyrtare dhe duke miratuar shpenzimet e klubit. Ata duhet të planifikojnë një dhomë takimi përmes Koordinatorit të klubeve studentore jo më pak se një javë pasi u bë klubi zyrtarë.

4 – Njohja

Njohja duhet bërë përmes planifikimit të një takimi me studentët aktiv në klub, për të shqyrtuar projektet dhe vendimet që do të marrin, në ndihmë për procesin e zbatimit të tyre. Gjithashtu duhet të behët njoftimi i të gjithë studenteve të cilët dëshirojnë në mënyrë vullnetare të jenë pjesë e Klubeve studentore, duke aplikuar në cdo klub, me ane te formatit aplikuesë në Zyrën e Klubeve Studentore. Personi i kontaktit (koordinatori i klubeve studentore) nga organizata do të jetë në kontakt të vazhdueshëm për të njoftuar për kohën dhe vendin e mbledhjeve.

5 - Krijimi i një Statuti.

Të gjitha organizatat duhet të krijojnë një statut në mënyrë që të njihet zyrtarisht. Statuti duhet të jetë i hollësishëm dhe i thjeshtë, sipas dëshires, por formati themelore kusht duhet të ndiqen.

6 – Regjistrimi i Klubit.

Regjistrimi i klubit te ri bëhet në fund, i cili duhet të jetë i publikuar në faqen zyrtare të interneti. Klubi bën gjithashtu regjistrimin e të gjithë studentëve te cilët kanë aplikuar për qënien pjesë aktive në klub.

**Planifiki
mi i
projekteve
për
financim**

Për marrjen dhe përdorimin e fondeve nga një organizat një Klub studentor duhet që, projektet e ndërmarrë nga organizmat (departamentet, institutet, qendrat) e Universitetit “Marin Barleti” duhet të synojnë plotësimin e të gjithë objektivave strategjike të përcaktuara në dokumentet përkatëse, qofshin këto akademike apo joakademike. Ato duhet të synojnë përfshirjen e sa më shumë studentëve dhe pedagogëve, sidomos përmirësimin e imazhit të universitetit në mjedisin social. Projektet mund të realizohen në fushën politike, ekonomike, juridike, sociale, kulturore, artistike dhe sportive, si dhe në dimensionin e ndërkombëtarizimit të UMB.

Shuma e kërkuar duhet të specifikohet në bashkëpunim me sektorin e marketingut dhe të marrëdhënieve me publikun.

Projektet duhet të synojnë të jenë afatgjata dhe të ruajnë një lloj vijueshmërie, si dhe të kërkojnë bashkëpunimin me sa më shumë organizma të tjerë mbështetës.

Projektet duhet të përshkruajnë target grupin të cilit i drejtohen dhe kohën e saktë të realizimit.

Niveli i pagesave duhet të konsultohet me zyrën financiare dhe nuk duhet të jetë më i lartë se sa pagesa të ngjashme për veprimtari të ngjashme, duke synuar edhe një lloj unifikimi të pagesave dhe një listim paraprak të tyre.

Pas përfundimit të projektit, duhet të paraqitet një raport për ecurinë e projektit dhe një raport i hollësishëm financiar.

Aplikimet për projekte mund të bëhen dy deri në tre herë në vit, në data të përcaktuara, gjithmonë duke pasur parasysh edhe vitin akademik, dhe jo vetëm atë kalendarik.

Do të mbështeten projektet që janë më të qarta për sa u përket objektivave dhe rezultateve.

Projektet duhet të plotësohen sipas formatit përkatës. Duhet pasur parasysh:

- Saktësia në përmbushjen e formatit
- CV nuk duhet të jenë më të gjata se një faqe
- Të përshkruhet me hollësi organizata përkatëse, veprimtaritë dhe arritjet e saj
- Në qëllimet e projektit duhet pasur parasysh që ato të jenë të qarta dhe të hollësishme
- Në përgjigjen e projektit duhet të përshkruhet rëndësia e projektit, pse ai duhet të financohet, ndikimi i projektit, duke paraqitur edhe materiale shtesë
- Përshkruani ndikimin afatgjatë të projektit dhe si mund të vazhdojë projekti pas përfundimit të financimit
- Duhet të keni kujdes kohën e realizimit të projektit, që të mos përplasat me kohën e miratimit të projektit
- Kujdes buxhetin e detajuar që të jetë sa më realist
- Përveç buxhetit të detajuar kërkohet edhe një përshkrim i tij narrative
- Shpenzimet e projektit duhet të mbulojnë të gjitha kostot e veprimtarive të projektit
- Shpenzimet administrative përfshijnë shpenzimet e komunikimit, telefona, faks, postë,

- fotokopje, printime, etj.
- Përveç financimit të UMB kërkohet edhe financimi nga organizma të tjerë. Gjetja e bashkëfinancimit është një argument më tepër për financimin e projekteve
 - Në projekt duhet të përshkruhet me hollësi edhe ndihmesa jofinanciare që jep organizata, qoftë kjo punë vullnetare, apo përdorim mjetesh private
 - Përpara se të dorëzohet, formati i projektit duhet të kontrollohet për gabime. Projekti duhet të jetë i lexueshëm dhe i qartë

Forma e projektit:

Titulli i projektit:

Emri i organizatës:

Adresa:

Telefon/Fax; e-mail:

Përfaqësuar nga (emri, funksioni):

Kurrikulum i përfaqësuesit (lutemi të paraqisni bashkëngitur jetëshkrimin e përfaqësuesit dhe të personave që do të punojnë për projektin):

Përshkrimi i organizatës (lutemi të bashkëngjisni kopje të dokumentacionit ligjor):

Koha e realizimit të projektit:

Shuma e kërkuar (në _____):

Përshkrimi i projektit:

Qëllimet e projektit (cilat janë objektivat dhe si do të maten rezultatet)

Përligjja e projektit (lutemi përshkruani problemin që do të zgjidhë projekti dhe grupin të cilit i drejtohet) _____

Si do të vijojë projekti pas përfundimit të financimit (a ka vijueshmëri projekti):

Përshkrim i hollësishëm i veprimtarive të projektit:

Buxheti i detajuar (nëse është e nevojshme përdorni disa fletë formati):

A ka burime të tjera financimi (cilat janë organizatat e tjera ku keni aplikuar për këtë projekt):

Tiranë, më _____

Firma e aplikantit

Evente

t

Planifikimit ne teresi i aktiviteve

1. Planit paraprakisht.

Sa më shumë kohë që të lejojë organizata juaj për të përgatitur ne tërësi planin e ngjarjes tuaj, aq më i suksesshëm do të jetë. Është e rekomanduar që ju të filloni fazat e para e planifikimit tre javë para datës së ngjarjes tuaj. Gjithashtu, duhet të plotësoni një punë të planifikuar ngjarje për të ndihmuar me të gjitha aspektet e planifikimit tuaj dhe ngjarjet e Studentit do të kategorizohet në mënyrën e mëposhtme:

o Niveli i parë: Takimi klubit apo mbledhjen e vogël për një audiencë të brendshëm te UMB

o Niveli i dytë: Komunikimi për të fituar ose formën e prezantimit një audiencë të brendshëm dhe UMB

o Niveli i tretë: të tregojm ngjarje pasiv ose ngjarje aktive të tilla si një musik apo ngjarje politike, të tilla si shfaqjen e filmit, apo ngjarje te dites.

2. Zgjidhja e nje date.

Klubet studentore, Kalendari është një mënyrë e mirë për të filluar në kërkim në të cilat datat nuk janë tashmë të rezervuar me ngjarjet ,një shpresë për të planifikuar. Duke diskutuar data me Studentëve Aktivitetet dhe këshilltaret e organizatës tuaj është gjithashtu e rëndësishme sepse mund të ketë rekomandime shtesë që do të ndihmonte për të prodhuar frekuentimin maksimal. Koordinator i klubeve për aktivitetet e studentëve apo i deleguari i saj për miratimin e natyrës së ngjarjes,duhet qe studentin ta njoftoje për miratimin e ngjarjes me e-mail. Nëse ngjarje është miratuar, ajo do të jetë e postuar në Kalendari Klubeve.

Nëse ngjarjet do të anulohet, njoftonet Zyra e Dekanit dhe Prorektorit te Studenteve gjithashtu dhe Koordinatorit te klubeve duke treguar emrin e ngjarjes dhe datan per një anulim, njohje do ti dërgohet dhe departamenteve të tjera.

3. Përzgjedhja e Vendit.

Pasi të keni zgjedhur një datë për veprimtarinë tuaj hapi tjetër është që të zgjidhni vendin për ngjarjen tuaj. Kur zgjedhjen e një vend të mbani në kufijtë e kapaciteteve mendje dhe cila hapësirë më së miri do të duhet për të akomoduar numrin e pjesëmarrësve qe jeni duke pritur?

Pasi të keni vendosur në një hapësirë të plotësoni një rezervimi e salles dhe kërkesë për ta vendosur në UMB-website. Të plotësoni formularin në tërësinë e saj dhe në qoftë se keni nevojë për një të veçantë për shërbimin e pijeve ose kanë nevojë për audio-vizuale. Pasi ju e dërgoni

4. Zhvillimi i një buxheti dhe fondi.

Një buxhet për çdo rast që ju plan qe është i nevojshëm për të siguruar të gjitha nevojat e ngjarjes tuaj mund të përmbushen dhe ti dergohet Dekanit te aktivitetit dhe me pas per miratim nga financa .

Listë e plotë planit te eventit

1. Duke bërë plane e hershme

-Fillimi planifikimin të paktën 2 jave para.

2. Identifikimi dhe duke vlerësuar nevojat e interesit

-Kush është audienca juaj?

- Vlerësimi

- berja e pyetësorëve të veçanta

- bisedat joformale

-Dëgjimi dhe vëzhgimet e përgjithshme

-Programi sugjerime

3. Zhvillimi i një Qëllimi

- Cilat janë qëllimet tona?

-Çfarë duam që audienca jonë të marrë nga ky program? (Rezultatet)

4. Program Ide

- Mundësitë janë të pafundme - ndonjë ide është një e mirë

-Përdor burimet dhe BE CREATIVE

5. Zgjidhni Programi juaj

-Sa i realizueshme është programi? (Vlerëso)

- Sa është përfshirëse programi?

- Cilat janë burimet e disponueshme?

-vullnetarë adekuate për të planifikuar dhe kryer ngjarje

-Projekti i një audiencë të synuar

6. Përgatitja e Buxhetit dhe Time line

- Krijo një buxhet realist (me vlerësimet aktuale për të gjitha shpenzimet, p.sh. honorare, publicitetet ,shtypje, ushqim, , udhëtimit, tarifat e regjistrimit, pajisjet, objektet, të sigurisë kampus,...)

- Sigurimi Financimi

- Është e vështirë për të mbledhur fonde, kështu që fillojnë herët.

-Përgatitja e një buxhet i detajuar

- Zhvillimi në kampus listën e financimit

- Përcaktoni se çfarë duhet të realizohet në planin e këtij programi

-Përcaktoni se sa kohë do të marrë për të kryer çdo hap të planifikimit.

-Përdorimi programeve për të planifikuar detyrat tuaja në përputhje me rrethanat.

7 Detyrat

-studentët / organizatat që janë të interesuar për të ndihmuar këtë plan program.

-afate të qarta

8. Publicitet

- Të përcaktuar se cilat teknika promovuese nga Publiciteti Timeline prospekt do të jetë më të suksesshme në arritjen e audiencë potenciale.
- Përdorim i shumë metoda të jetë e mundësuar arritjet e nje audience më të gjerë.
- të monitorojnë nga afër se sa është zhvilluar interesi në program, rregullo metodat e publicitetit si të nevojshme për përgatitjen e një fushatë reklamuese në minutën e fundit në qoftë se shpresat nuk janë duke u përmbushur.
- Organizoni post-ngjarje për mbulim, si një artikull në një gazetë apo një foto kampus në faqen e internetit të klubit.
- Sponsorizuar nga Zyra e Aktiviteteve Studentore.

Memo

Si të përgatiteshi një mëmo e cila do të paraqitet tek Dekani, Pro Rektori i Studentëve dhe Koordinatori i klubeve studentore, ku më pas ky i fundit, do t'ia shpërndaj të gjithë departamenteve duke i njohur rreth aktivitetit dhe projektit të realizuar ose që do të realizohet në të ardhmen.

Memoja ndërtohet në mënyrë të tillë që përmban:

- Emrin dhe adresën e dërguesit dhe atij që i drejtohet
- Emrat personal dhe pozicionet drejtues
- Logoja e institucionit dhe e juaja.
- Eventi / projekti do të jetë në formën e përshkrimit të ngjarjes / projektit,
- Informacioni dhe kontakti i dërguesit.

**Listë e
eventeve të
Klubeve
Studentore**

Liste aktivitetesh per SEC

“Barleti” Business Incubator Center

Business Plan Competition

“Corporate Social Responsibility” Forum

Cross Border Student Entrepreneurship
Periodical of Student Entrepreneurship
and Enterprise Portal

- ❖ Cikël seminaresh të hapura për ndërmarrjet e studentëve tek shkollat e mesme me qëllim përhapjen e kulturës sipërmarrëse.
- ❖ Seminare me temë “Biznese të iniciuara” nga studentë apo të diplomuar
- ❖ Projekt ide nga arena studentore, për prespektiva zhvillimi produkteve tek kompanitë e medha.
- ❖ Roli i sipërmarrjes në mirëqënien shumëplanesh të shoqërisë – Seminar në bashkëpunim me **Institutin e Kërkimit dhe Zhvillimit Barleti** .
- ❖ Mundësitë e financimit të ideve novatore nga sistemi bankar shpëtar – Seminar me bankat e nivelit të dytë në vend.
- ❖ Model i ri ekonomik ku të përfshihet stimulimi i sipërmarrjeve studentore si nisma me background që ofrojnë probabilitet të lartë suksesi – Seminar me pjesëmarrës nga Banka e Shqipërisë.
- ❖ Orientimi i financuesve të huaj si IFC dhe BERZH edhe tek sipërmarrja studentore - Seminar
- ❖ Artizanati dhe mikro-ndërmarrjet - Seminar
- ❖ Seminar në bashkëpunim me Bashkinë për stimulimin e sipërmarrjes së vogël studentore “Roli dhe Inkurajimi i grave në sipërmarrje”
- ❖ Pakicat etnike në sipërmarrje – Seminar
- ❖ Biznesi familjar- Fokusim tek përcjellja e trashëgimisë tek të rinjtë
- ❖ Ekonomia dhe sipërmarrja Sociale
- ❖ Promovimi i sipërmarrjeve studentore në TV dhe në Media të tjera audio vizuale.

Partnerët

Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë

Dhoma Amerikane e Tregëtisë

Fondacioni Soros

Korporatat më të rëndësishme

IFC

Donatorët potencial

Amb.Hollandeze

Amb.Britanike

Amb.Gjermane

Amb. Amerikane



Listë evente të klubeve.

Listë Aktivitesh të Klubit Bota
Studentore “KBS”

Student Life Club “Marin Barleti”
Campus

Jeta studentore në universitetet jopublike- çfarë do të ishte më e nevojshme për studentët e UMB-së që të gjenden pranë Universitetit tone:

- ❖ Inkurajimi i pjesëmarrjes së studentëve në iniciativat politiko-social-ekonomike.
- ❖ Shqipëria është Kulturë- iniciativë e UNESCO-S, MIN. TURIZMIT për promovimin e turizmit shqiptar, sidomos të zonave të vecanta.
- ❖ Ore te hapura: me specifika te ndryshme dhe ne perputhje me realitetin.
- ❖ Trevat shqipëtare, Kulturë, ekonomi dhe dimension i ri shoqëror, vizitë njohëse për studentët e UMB-së.
- ❖ Kontakte me real estate dhe me bankat e ndryshme që mundësojnë kredi të buta apo të favorshme për studentët.
- ❖ Organizimi i ekskursioneve “exploring THE New Face of Tirana” nga ku do të inkurajohen studentët që individualisht të shohin dhe eksplorojnë këto zona, kështu nderthurim të bukurën me utilen , në këtë mënyrë testojmë dhe çfarë është më e nevojshme për produktin e ardhshëm të mundshëm.

Listë evente të klubeve



- ❖ Takim me analist, gazetar, opinionist rreth gjithë këtyre ndryshimeve të reja që po ndodhin në Shqipëri. Ku po shkon Shqipëria?
- ❖ Shkolla (universitare), "A është shkollë demokracie? Dmth a fabrikon ajo lidera të së ardhmes, të brumosur me të gjitha parimet demokratike, të denje për të kontribuar në zhvidhimin e mëtejshëm të demokracisë sonë.
- ❖ "Ne fillojmë të vdesim pak e nga pak, kur pushojmë së interesuari për problemet që na prekin" (Martin Luter King). Diskutime, lidhur me arsyet se pse ka rënë interesi i qytetarëve në lidhje me politikën, që dashur padashur është ajo që vendos kornizat jo vetëm ligjore, brënda së cilës rregullohet jeta jonë.
- ❖ Të gjithë jemi pjestarë të shoqërisë, por ama jemi dhe pjestarë të një rrethi më të ngushtë atij universitar. Jeta në universitet sa mirë është? Si mund të bëhet më mirë? Diskutime mes studentëve.
- ❖ Në një vend demokratik liria e fjalës dhe e shprehjes mbrohet me ligj dhe cilësohet si një ndër "gurët e themelit", mbi të cilët ngrihet një shtet demokratik. Debate dhe diskutime. A jemi realisht të lirë të shprehim atë që mendojmë? Sa mbrohet dhe respektohet një e drejtë e tillë në Shqipëri? Biseda dhe me pedagoge të drejtave të njeriut brenda universitetit.
- ❖ Organizimi i një minikonkursi me studentët e universitetit (të të gjitha fakulteteve), për një esse në lidhje me demokracinë në Shqipëri: "Refleksionë individuale mbi funksionalitetin e demokracisë Shqiptare", me juri të përbërë nga pedagogë të shkencave politike.

Listë event të klubeve



Programmi i Klubeve Studentore

Programi i Klubeve Studentore

Të gjithë jemi pjesë e shoqërisë, shoqëria është tërësia e organizatave dhe institucioneve shoqërore qytetare vullnetare që formojnë themelin e funksionimit të shoqërisë. Ashtu si dhe shoqëria klubit në thelbin e tyre janë organizma vetëorganizues dhe në qëndër kanë studentin, qëllimi i cdo klubi është të inkurajojë dhe të ndihmojë në zgjerimin e njohurive të përgjithshme dhe të aftësive drejtuese të çdo studenti. Kampusi i Univesitetit “Marin Barleti” tashmë ka ngritur gjashtë klubit studentore të cilët janë:

Klubi Bota Studentore (KBS) njeh në thelbin e tij rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në organizatë, tek e cila ofrohet një mundësi për zhvillimin të aftësive në udhëheqje, ndërveprim shoqëror si dhe një ndjenjë e pjesëmarrjes në komunitet e sidomos në kapusin studentor- Kampusi studentor shihet nga pikevështrimi i një bote tjetër parapërgatitore për jetën reale që e pret studentin pas mbarimit të studimeve. Klubi i botës studentore beson se pjesëmarrja në një organizatë është një nga përvojat më të rëndësishme dhe të dobishme në të cilin një student mund të përfshihet, mundësia e bashkëveprimit me studentët dhe me klubit e tjera, si dhe nxitja e interesave të tyre të veçanta jashtë kampusit. Qëllimi i Klubi Bota Studentore (KBS) është të krijojë një ambient ku studenti mund të masë dhe zhvillojë aftësitë dhe ambiciet e tij. Zhvillimin e aftësive sociale nëpërmjet ndërveprimit shoqëror, zhvillim të aftësive drejtuese dhe të një qytetarie të mire. Zhvillim i student përfshires në komunitet përmes vullnetarizmit, për të promovuar kampuse pozitive / ndërveprim të komunitetit. Zhvillimi i aktiviteteve që sjellin nxitje kulturore, intelektuale, arsimore dhe sociale të komunitetit kampus.

Klubi i debatit DiDi ka për mision që të nxisë shprehjen e lirë të pikëpamjeve të studentëve për demokracinë, duke krijuar atmosferën e përshtatshme për këtë qëllim. Me ndihmën e debateve zhvillohet aftësia e të menduarit dhe të gjykuarit kritik. Gjatë debateve, studentët shfaqin aftësitë e tyre të lidhshimit, të punës në grup, të folurit publik, të aftësisë për të dëgjuar, të kontrollit të emocioneve dhe tolerancës. Klubi synon të rrisë pjesëmarrjen e studentëve dhe informimin e tyre në fushën e demokracisë. Klubi nxit konkurrencën, aftësitë analitike dhe komunikative, ndershmërinë, koherencën dhe zbatimin e rregullave të përcaktuara qartë. Klubi do të sigurojë edhe pjesëmarrjen e studentëve në debate publike për çështje publike, duke siguruar standarde të larta sjelljeje përkundrejt publikut. Në këtë klub japin kontributin e tyre përmes bashkëpunimit studiues të njohur të shkencave politike e sociale, protagonistë të jetës social-politike të vendit, etj.

Klubi Ligji dhe Demokraci funksionon pranë Univesitetit “Marin Barleti”. Qëllimi primar i këtij Klubi është të zgjerojë kulturën juridike kryesisht tek studentët e Universitetit Marin Barleti, por edhe më gjerë, nëpërmjet interpretimit të jurisprudencës së gjykatave shqiptare por edhe të atyre ndërkombëtare, si dhe nëpërmjet organizimit të eventeve mbi diskutimin e tendencave të ligjit dhe të shtetit të së drejtës, me profesionistë të shquar së drejtës në Shqipëri. Qëllimet e Klubit Studentor “Ligji dhe Demokracia” janë: Zhvillimi dhe kultivimi i debatit

shkencor tek studentët, zhvillimi nën drejtimin e Fakultetit të Drejtësisë të punimeve kërkimore-shkencore, me qëllim zgjerimin e pavarësisë shkencore tek studentët si dhe thellimin e dijeve juridike të përfituara prej tyre Promovimi i Universitetit “Marin Barleti”. Zgjerimi i njohurive të përgjithshme dhe të aftësive të studentëve. Zgjerimi i kontakteve ndërkombëtare dhe i bashkëpunimit shkencor me organizata të tjera . Dhënia e ndihmës për të gjetur literaturën e duhur bashkëkohore për lëndë të caktuara si dhe ndihma në krijimin e lehtësirave të tjera, që lidhen me studimin Zhvillimi i aftësive organizative dhe ndërpersonale të anëtarëve të Klubit

Klubi kultura,media dhe teknologjisë e reja është një organizim i Universitetit “Marin Barleti” ,në këtë qëndër japin kontributin e tyre përmes bashkëpunimit, disa nga gazetarët më në zë, si dhe profesionistë të shuar nga grupe mediatike dhe kompani teknologjike. Media është organizimi ideal për të ndërtuar dhe forcuar marrëdhëniet midis studentëve dhe lojtarëve kryesorë të tregut mediatik. Përmes botimeve, realizimeve radiotelevizive dhe eventeve të ndryshme të organizuara nga klubi i Mediave të reja dhe teknologjisë. Klubi u jep studentëve mundësinë të zgjerojnë rrjetin e njohjeve ndër profesionistë të fushës për të zhvilluar qysh në vitet e shkollës karrierën e tyre të ardhme. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me gazetarët dhe grupet mediatike më të spikatur në vend, misioni i klubit është të ndihmojë studentët të zbulojnë dhe zhvillojnë talentin në fushën mediatike duke i përfshirë ata në përvoja praktike në fushën e larmishme të mediave dhe teknologjive më të reja. Klubi kultura,media dhe teknologjisë e reja në Universitetin “Marin Barleti” tenton kështu të bëhet një urë lidhëse midis kompanive mediatike dhe teknologjike pararojë, dhe studentëve tanë më premtues.

Klubi i sipërmarrjes studentore SEC, është një klub studentor i cili është themeluar si përgjigja kombëtare ndaj trendeve ndërkombëtare të strukturave të ngjashme të ngritura pranë universiteteve me prestigjioze. Ky klub me anëtarët e vet që kanë treguar se disponojnë aftësi që i dallojnë nga koleget e tyre është ngritur si kërkesë e pa delegueshme e shoqërisë për ide dhe energji të reja në sipërmarrje. SEC ose në termin e shqiptarizuar “klubi i sipërmarrjes studentore” beson në sigurimin e mbështetjes së cdo ideje inovatore nga cdo rajon në zhvillim e sipër, dhe që nëpërmjet angazhimit të klubit në format dhe mënyrat me efikasë të mundësojë vënien në jetë të idesë duke ndikuar kështu në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Klubi është një laborator për studentët dhe të diplomuarit me prirje dhe interesa sipërmarrëse, të cilët duan të realizojnë idetë e tyre. Filozofia jonë është konsolidimi i njohurive nëpërmjet eksperiencës, e cila është arsyeja pse ne përqëndrohemi më shumë në idenë se sa tek rezultati përfundimtar. Si pjesë e klubit ju do të keni mundësinë për të marrë pjesë në procese dhe veprimtari, ku do të mësoni se si të realizoni praktikisht idetë tuaja.

Klubi Vullnetarë në Shoqëri ka për mision ndërtimin e një skuadre vullnetarësh nga studentet e UMB-së për qëllim kultivimin, zgjerimin dhe mësimin e ndjenjave njerëzore në shoqërinë Shqiptare, nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete dhe organizime të ndryshme vullnetare, të drejtuara tërësisht nga ideja e ndihmes kundrejt njëri-tjetrit, prej të cilës i vetmi shpërblim është ndenja e përkatësisë individuale dhe kolektive brenda këtij rrethi shoqëror ku jetojmë e punojmë

cdo ditë. Më konkretisht ndër detyrat dhe qëllimet e Klubit Studentor “Vullnetare ne Shoqeri” janë: Zhvillimi dhe kultivimi i ndjenjave njerëzore sic janë dashamirësia, ndihma, dhëmbshuria, bamirësia, përulesia, krenaria dhe toleranca si celësa për të shërbyer ndaj të mirës së përbashkët ose interesit publik. Zhvillimi nën drejtimin Zyrës së Aktiviteteve Studentore, të aktiviteteve me inicim direkt nga UMB ose nga një organizatë e jashtme për të dhënë kontributin në jetën e përditshme Shqiptare. Promovimi i Universitetit “Marin Barleti”, zgjerimi i njohurive të përgjithshme dhe të aftësive organizative, komunikative e drejtuesve të studentëve, zgjerimi i kontakteve vendase dhe ndërkombëtare dhe i bashkëpunimit me organizata të të dyja llojeve.

Bashkëpunimi

Politika e bashkëpunimit te klubeve

Te gjitha klubet ne veçantin e tyre kane si synim bashkëpunimin ne menyre qe te krijojne fusha me te gjera per bashkëpunime ne te ardhmen dhe donatore dhe institute te ndryshme.

Klubi Bota Studentore është çelur pikërisht për të ndërtuar dhe forcuar bashkëpunime intensive midis potencialeve akademike dhe studentore të Universitetit Marin Barleti dhe aktorëve kryesorë në fushat të ndryshme te edukimit, drejtësisë, kulturës, sportit, etj. Bashkëpunimet shtrihen në fushën e komunikimeve, organizimeve kulturore sportive, seminareve si edhe në ngritjen e portaleve online dhe publikimet. Per me teper Klubi Bota Studentore do të mundësojë organizimin e orëve ëe hapura “open classes” me të ftuar te fushave të ndryshme duke organizuar kështu shkëmbime mendimesh *pares-inter-pares* mes studentëve dhe specialistëve, ku studentët tanë jo vetëm të përballen me realitetin por dhe të shohin perspektivën e tyre të mëtejshme. Klubi Bota Studentore duke pasur një objekt aktiviteti shumë te gjërë do te angazhohet si për mbështetjen e klubeve të tjera aktive dhe ekzistuese po ashtu do të koordinojë dhe mbikqyri aktivitetet e tyre në mënyrë që të formojë një “guide” për studentët për sa kohë ata ndodhen brenda kampusit universitar si aktorë kryesorë të kësaj Bote Studentore me të cilët dhe për të cilët janë krijuar këto organizma.

Klubi DiDi është çelur pikërisht për të ndërtuar dhe forcuar bashkëpunime intensive midis potencialeve akademike dhe studentore të Universitetit Marin Barleti dhe aktorëve kryesorë në fushën e politikës dhe shoqërisë. Bashkëpunimet shtrihen në fushën e debateve, komunikimeve, si edhe në ngritjen e portaleve online dhe publikimet.

Klubi kultura,media dhe teknologjisë e reja është çelur pikërisht për të ndërtuar dhe forcuar bashkëpunime intensive midis potencialeve akademike dhe studentore të Universitetit Marin Barleti dhe aktorëve kryesorë në fushën mediatike dhe të teknologjisë. Bashkëpunimet shtrihen në fushën e botimeve, prodhimeve radiotelevizive si edhe në ngritjen e portaleve online dhe eksplorimin e mediave të reja përmes teknologjisë moderne.

Bashkëpunimi me UMB, për klubin e sipërmarrjes, është thelbësor jo vetëm në shfrytëzimin e ambjenteve dhe infrastrukturës për mbarëvajtjen e operimit të klubit por edhe për ekspertizën akademike që stafi universitar i UMB-së vendos në dispozicion të klubit për probleme që kërkojnë nivel të lartë ekspertize dhe profesionaliteti.

Klubit Studentor Vullnetare ne Shoqeri” ka mënyrat se si do të realizohen objektivat e sipërpërmendura te cilat janë: Trajnim mbi ndenjat njerëzore, lektore psikoanalist, media, historian ,organizimi i aktiviteteve vullnetare në ditë botërore të caktuara sipas kalendarit të OKB-së. Sigurimi i pjesëmarrjes në aktivitete të zhvilluara nga organizata të tjera, publikimi i buletinëve dhe/apo broshurave në bazë të punës vullnetare të organizuar nga UMB. Bashkëpunimi me institucionet vendase dhe të huaja, pjesëmarrja në lëvizjen vullnetare te ndryshme, thellimi i bashkëpunimit me institucione jo-fitim prurëse.

**Të drejtat
dhe detyrat
e Zyrës së
Klubeve
Studentore**

Zyra e Klubeve Studentore

Zyra e Klubeve studentore drejtohet nga Koordinatorja e Klubeve Studentore Znj.Anisa Brano.

Zyra e Klubeve Studentore është një zyre e cila ka si funksion primarë koordinimin mes Këshilltarëve të Klubeve dhe përfaqësueve aktivë në klubë (të cilët janë vetë studentët). Është një zyrë e cila funksionon si e pavarur nga ana organizative, duke u vetëorganizuar dhe duke i ardhur në ndihmë të gjithë organizimave administrativë ose akademik për bashkëpunim në fushat specifike që Klubet studentore përmbajnë. Nga ana administrative Zyra është e varur drejtpërdrejt nga Dekani i Studentëve.

Zyra ndihmon që studentët të bëjnë lidhjet në nivele kulturore apo akademik. Përfshirja në Klube , gjithashtu u mundëson të fitojnë përvojë në terren, kur ata punojnë me një grup që lidhet me planin e tyre .Mundëson përfaqësimin në rrugët më të dukshme dhe të arritshme për përfshirjen e studentëve. Në Universitetin “Marin Barleti” ka 6 (gjashtë) klube studentore Klubi Bota Studentore (KBS), Klubi Ligj dhe Demokraci (KLD), Klubi Debat dhe Demokraci (DiDi), Klubii Sipermarjes (Entrepreneurship SEC), Klubi Vullnetare ne Shoqeri (KVSH) Klubi Kultura,Media dhe Teknologjitë e Reja, që i përshtaten një sërë interesat dhe nevojave.

Zyra e klubeve bashkë me Këshilltarët e klubeve ndjen të nevojshme krijimin e një plani që integron ndjekjet akademike dhe të interesave të karrierës, i cili do të përcaktojë zgjedhjet që bëjnë në lidhje me kohën që shpenzojnë studentet jashtë Kampusit. Përfshirje aktive si brënda dhe jashtë UMB- së, duke kontribuar në përvojën e studentëve aktivë. Përveç kësaj, përfshirjen dhe të përvojave në auditore te cilat ndihmojnë të zhvillojnë lidhshëm të vlefshme dhe aftësi organizative ku kontribuojnë në tregtueshmërinë e studentëve.

Zyra studentore është një pjesë integrale e jetës studentore në kampus tonë, si dhe reflekton interesat të ndryshme dhe aktivitete të komunitetit tonë studentorë.

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Zyra e Klubeve studentore mundëson dhe siguron formularë për aplikim në klubet studentore dhe disponon një database me të dhënat e të gjithë të regjistruave nëpër klube të ndryshme.
2. Luan një rol të rëndësishëm në koordinimin e mbledhjeve dhe takime të këshilltarëve të klubeve dhe të vetë klubit në vecanti , duke përcaktuar oraret dhe vendet e takimeve.
3. Mundëson që të njihemi me të gjithë aktivitetet dhe projektet duke publikuar një kalendarë mujorë.
4. Është iniciatore e shumë aktiviteteve të cilat janë të vetë organizuara nga klubet studentore ,duke ndihmuar në përgatitjen e një memoje prezantuese , paraqitjen në Web të aktivitetit me imazhe të fotografuara nga vetë Zyra.

5. Zhvillon veprimtari që sigurojnë një mjet për bashkimin e komunitetit kampus me nxitjen e marrëdhënieve pozitive mes studentëve të fakulteteve, dhe kampuseve të tjera.
Aktivitete që nxisin zhvillimin e suksesshëm të personaliteteve të studentëve, aftësitë intelektuale, edukative , aftësitë fizike, sjellin nxitje kulturore, arsimore dhe sociale të komunitetit kampus.
6. Jep informacion më të detajuar mbi cdo aktivitet dhe fushë në të cilën janë përcaktuar dhe mundëson komunikim me një rrjet të madh profesionistësh në fushat e organizimit dhe lidhshimit.
7. Publikon dokumenta informative mbi veprimtarinë e Klubeve dhe organizimin e takimeve të shpeshta me profesionistë të fushave përkatëse.
8. Mbikëqyr dhe ndihmon këshillat e klubeve dhe përfaqësuesit (studentët) duke i orientuar dhe ndihmuar në organizimet e takimeve, mbledhjeve, paraqitjes së projekteve dhe përcjelljen e cdo projekti drejt Dekanit të studentëve.
9. Ndihmon dhe bashkëpunon në projektet të cilat kanë natyrë kulturore, turistike gjithashtu i vjen në ndihmë për bashkëpunim Zyrës së marketingut në përmbushjen e nevojave më natyrë promociionale.
10. Vë në praktik të gjitha projektet të cilat vinë nga departamentet apo nga administrata në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë Klubet dhe studentët e UMB-së.